



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 930 / prot.

Tiranë më 14 / 2019

Lënda: Përgjigje kërkesës për mendim

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORISË SË PROGRAMEVE ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi u njoh me kërkesën tuaj për mendim, administruar me nr. 930 prot., datë 11.06.2019, lidhur me publikimin e të dhënave të përfituesve të mbështetjes financiare nga Programi i Fondit të Ekselencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sjell në vëmendjen tuaj vlerësimin bazuar në parashikimet konkrete të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Referuar kërkesës, vlerësojmë se në lidhje me legjitimitimin e publikimit të të dhënave personale, në çdo rast, vendimi i “Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, në cilësinë e kontrolluesit, duhet të jetë në respekt të të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në nenin 5 dhe në përputhje me një nga kushtet e parashikuara në nenin 6 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Vetëm në këtë rast përpunimi/publikimi do të konsiderohej i ligjshëm.

Në nenin 6/1/ç/d “Kriteret ligjore të përpunimit” përcaktohet përpunimi i të dhënave personale, ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, të dhënat e subjekteve të të dhënave (përfitues të mbështetjes financiare nga Programi i Fondit të Ekselencës), mund të publikohen duke qenë se në këtë rast prevalon interesi publik dhe bëhet fjalë për fonde publike por edhe duke u referuar në dispozitat ligjore konkrete që e rregullojnë këtë përpunim të dhënash personale, sipas ligjit të referuar prej jush.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

